

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: Gjuha frënge

(klasa e katërt)

VITI SHKOLLOR 2007--2008

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. TË PËRGJITHSHME
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE
- III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT
 - 1.Sfera tematike dhe leksiku
 - 2.Aktet, funksionet komunikuese
 - 3.Elemente dhe struktura gramatikore
 - 4.Shpërndarja e orëve
- V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VI. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI

TË PËRGJITHSHME

Mësimi i gjuhës së huaj në shkollën fillore ka zënë vendin e tij me dinjitet në fushën e mësimdhënies dhe të përgatitjes së nxënësve me njohuri të denja si qytetar i Evropës së bashkuar. Programi i kl. IV është një rimarrje e njohurive të klasës III, por që pasurohet pak nga pak me njohuri të reja dhe që shton dinamizmin dhe motivimin e fëmijës. Nxënësi shikon, dëgjon, kupton dhe riprodhon mesazhe të thjeshta, fillon të organizojë fjalët në mënyrë gjithnjë e më komplekse, sipas ritmit të tij psikologjik dhe intelektual. Nxënësi duhet të gëzojë mundësinë për ta përjetuar gjuhën e huaj në tërësinë e vet, d.m.th. fjalorin e pastër, shumëllojshmërinë e strukturave gramatikore, si dhe kulturën, pjesë e së cilës është kjo gjuhë.

I. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE

a-Synime edukative

Mësuesi krijon tek nxënësit hapësirë që të zbulojë, të veprojë dhe të bashkëveprojë për ta mësuar këtë gjuhë. Nxënësi ka nevojë që në moshë të vogël për një aftësi komunikuese ndërkulturore, e cila zhvillohet përmes katër aftësive gjuhësore:

-dëgjimit;

-leximit;

-të folurit;

-të shkruarit.

Në këtë nivel mësimi bëhet sa më zbavitës. Çdo teknikë apo formë pune e përdorur, duhet të përmbajë një element loje. Lojërat dhe veprimtaritë zbavitëse i bëjnë fëmijët të ndjehen të motivuar dhe pjesëmarrës aktivë. Ata përdorin fraza të thjeshta dhe të kuptueshme në situata të përshtatshme nga jeta përreth tyre. Mësimi i gjuhës së huaj ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit, në aspektin njohës, gjuhësor dhe emocional.

b-Objektivat didaktikë

Qëllimi i mëimit të një gjuhe të huaj nuk është thjesht aftësi gjuhësore, njohja e rregullave gramatikore, morfosintaksore, leksikore, por aftësia komunikuese që nënkupton formimin sociolinguistike, ekstragjuhësore, përveç atyre gjuhësore.

c-Objektiv për komunikimin

Duke i dhënë përparësi komunikimit, synojmë t'i japim nxënësit mjetet e duhura që do ta aftësonin atë të ndërvepronte aktivisht në situata dhe në kushte nga më të ndryshmet, d.m.th. edhe në situata jetësore jashtëshkollore. Pra vihet theksi tek përdorimi i gjuhës dhe jo tek aspektet strukturore dhe rregullat gramatikore.

d-Objektiv gjuhësor

Nxënësi në Kl. IV vazhdon të mësojë strukturat e gjuhës në mënyrë automate, pa e ngarkuar me rregulla gramatikore.

e-Objektiv sociokulturor

Nxënësi sensibilizohet me aspekte të kulturës të gjuhës që ai mëson.

III. PERSHKRIMI I AFTESIVE GJUHESORE

Realizimi i komunikimit arrihet nëpërmjet përvetësimit të katër aftësive gjuhësore të harmonizuara gjatë procesit mësimor.

Të dëgjuarit

Nxënësi kupton fjalë dhe shprehje shumë të njohura që kanë të bëjnë me veten, familjen dhe mjedisin përreth, nëse flitet ngadalë dhe qartë. Kupton pjesë të thjeshta me figura dhe me një fjalor të punuar më parë.

Të folurit

Nxënësi komunikon në mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë dhe qartë për gjëra të jetës së përditshme, si: familja, shkolla, shoqëria. Mund të formulojë pyetje të thjeshta që kanë të bëjnë me nevojat e tij imediate dhe t'u përgjigjet atyre.

Të lexuarit

Nxënësi kupton shprehje të thjeshta, si: lajmërime, afishe të ndryshme, orare kinemaje, teatri, programe televizive. Lexon me zë të lartë dhe kupton tekste të shkurtëra që përmbajnë fjalë dhe fraza të thjeshta me fjalor të njohur.

Të shkruarit

Shkruan një kartolinë të thjeshtë për Vitin e Ri, uron ditëlindjen dhe festa të ndryshme me fjali të thjeshta dhe fjalë të njohura, plotëson një formular me të dhëna vetjake.

IV.PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1.Tematika dhe leksiku

1. Veprimtaritë e përditshme:
 - ora,
 - ushqimi,
 - jeta shkollore (koha e lirë).
2. Jeta personale:
 - familja ime,
 - shokët e mi,
 - pushimet,
 - tualeti,
 - ditëlindja.
3. Numrat 20-50.
4. Bota rreth nesh (fshati, qyteti, shteti).
5. Koha.
6. Bota e komunikimit (letra, kartolina, telefoni).

2. Aktet dhe funksionet e komunikimit

- se présenter(je me présente)
- présenter qqun. (je vous présente)
- demander/donner une information:
Où est la maison,le cinéma...
- La maison est à droite, à gauche...
- proposer/refuser/accepter/inviter.
- conseiller qqun:Je te conseille...
- apprécier qqchose:cest super/merveilleux...
- décrire un objet/une personne
- exprimer ses goûts et ses préférences:
J'aime
J'adore

Je déteste
-décrire le temps qu'il fait:
Il fait beau,mauvais,il pleut...
-exprimer des voeux,des souhaits:
Joyeux anniversaire
Bonne fête.

3.Struktura gramatikore

-les adjectifs qualificatifs
-comparatif des adjectifs
-il faut + infinitif
-les adverbes de quantité(beaucoup,peu...)
-c'est + pronom tonique:
c'est moi,c'est toi...
-chez + nom:chez mon grand-père...
-chez + pronom:chez moi...
-l'initiation du passé composé,
du futur proche
-la structure: il y a...
il n'y a pas...
-les verbes:commencer,finir,partir,arriver,voyager,voir,boire,lire,pouvoir
(je peux+infinitif)

4. Shpërndarja e orëve

35 javë x 2 orë = 70 orë

Aspekti komunikues-kulturor:	32 orë
Aspekti gjuhësor:	28 orë
Të lira:	10 orë
<i>Gjithsej:</i>	70 orë

Aspekti komunikues- kulturor (32 orë). Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikues, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikimi, të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen dhe përforcimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

Aspekti gjuhësor (28 orë). Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përforcim të atyre të mësuara më parë apo edhe të atyre të reja.

Të lira (10 orë). Në këto të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen orë përsëritjeje, detyra kontrolli, plotësim të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikues, qoftë gjuhësor.

V METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PROGRAMIT

Përvetësimi i gjuhës së huaj në shkollë nuk është një proces natyror, por një proces i drejtuar nga mësuesi. Prandaj ai duhet të krijojë një klimë besimi dhe të gjejë forma dhe mënyra të tilla për ta motivuar nxënësin. Mësuesi nuk duhet ta mbajë veten si zotërues i vetëm i dijes, por duhet të bashkepunojë me nxënësin për të nxjerrë një përfundim të vetëmse nxënësi është pjesëmarrës në qendër të procesit mësimor. Të nxisë çdo nisativë të nxënësve që çon në përvetësimin sa më të mirë të materialit dhe bashkëveprimin në klasë. Mësuesi duhet të përdorë edhe mjete të larmishme që ngjallin interes te nxënësit dhe u mundëson kreativitetin.

Fonologji




Përvetësimi i mënyrave të reja të artikulimit nuk është i lehtë. Përsëritja e pastër dhe e thjeshtë e modelit të propozuar nuk mjafton për të krijuar automatizime gjuhësore, prandaj lind nevoja që të jepen materiale ndihmëse, si: rima, strofa dhe shembuj për t'i ndihmuar nxënësit të familjarizohen me intonacionin, ritmin, theksin dhe shqiptimin e fjalëve në fjali. Këto mund të jepen edhe përmes veprimtarive zbavitëse. Mësuesit këshillohet të përdorë materiale të regjistruara, si: magnetofon etj.

VI.METODOLOGJIA E VLERESIMIT DHE VETEVLERESIMIT

Vlerësimi i përparimit të nxënësve do të realizojë matjen e përparimit dhe arritjeve të tyre. Do të vlerësohen jo vetëm përvetësimet gjuhësore, por gjithashtu edhe mënyra e të sjellurit të nxënësve që përbën aspektin kulturor të tyre. Kjo mund të bëhet me anë të një grile vlerësimi me të dhëna, si: Unë jam i aftë të...

Kjo grilë përmban 5 kategori:

- dëgjimin,
- leximin,
- pjesëmarrjen në bashkëbisedim,
- të shprehurit me gojë,
- të shprehurit me shkrim.

Je sais			
Compter 1 à 50			
Dire le temps qu'il fait...			
Saluer...			

Kjo formë e lejon nxënësin të përmirësojë performancën e tij. Vlerësimi përbën një element thelbësor në mësimin e gjuhës së huaj. Funkcioni i tij është i trefishtë:

- 1) E lejon mësuesit të ndjekë përvetësimin e njohurive tek nxënësit, ritmin dhe rendësinë e tyre.

- 2) I lejon nxënësit të vendosen në tërësinë e aftësive të pritshme dhe të ndjekë ecurinë e tyre.
- 3) Është një ndihmesë për prindërit, të cilët ndjekin hap pas hapi ecurinë e fëmijëve të tyre.

KRITERE PER HARTIMIN E TEKSTIT

Në hartimin e tekstit të klasës IV duhet patur parasysh se kjo metodë i drejtohet një fëmijë 9-10- vjeçar që mëson një gjuhë të huaj. Fëmija ka nevojë për ngrohtësi, për lirshmëri, të ndihet i motivuar për të mësuar këtë gjuhë. Prandaj metoda duhet t'u përgjigjet kërkesave dhe interesave të kësaj grup- moshe. Nëpërmjet saj fëmija:

- të zbulojë,
- të veprojë,
- të bashkëveprojë.

Metoda duhet të jetë:

- Me ngjyra,
- Me personazhe të dashura për fëmijët,
- Plot me veprimtari ku fëmija të ketë mundësi të dëgjojë, të shikojë, të flasë, të prekë, të ndjejë gjatë bashkëveprimit me shokët në klasë.
- Veprimtaritë të nxisin imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijës.
- Rubrika për qytetërimin të jetë hapje ndaj kulturës frankofone dhe gjuhës franceze.
- Të ketë veprimtari që lidhin familjen me klasën, si, p.sh., fëmija sjell në klasë lodrën e tij të preferuar apo u tregon prindërve një vizatim që ka bërë në klasë etj.
- Të ketë veprimtari që e lejojnë fëmijën të ndjejë ritmin, tingullin dhe intonacionin e gjuhës (kasetë).
- Të ketë ushtrime me shkrim nëpërmjet historive, përrallave të shkurtëra, komente të thjeshta për figura, me etiketa.
- Të ketë veprimtari që forcojnë bashkëpunimin e shmangin konkurrencën.
- Të ketë veprimtari për të katra 4 aftësitë.
- Teksti të jetë i ndarë me njësi dhe me objektiva të qartë.
- Të ketë grila vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.
- Metoda të jetë e shoqëruar me libër mësuesi.